



ODA E AVOKATËVE TË KOSOVËS
ADVOKATSKA KOMORA KOSOVA
KOSOVO BAR ASSOCIATION

V. KD. Nr.23-1/2022

KOMISIONI DISIPLINOR I ODËS SË AVOKATËVE TË KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga Sarandë Beqiri - Kryetare, - Marigëna Berisha - anëtare dhe Fitim Shporta - anëtar, me pjesëmarrjen e Vjollca Ajeti - Administratore në Zyrën Disiplinore në OAK - Procesmbajtëse, duke vendosur lidhur me Propozimin e Prokurorit Disiplinor me nr.70-2/2021 të datës 29.09.2022, ndaj të paraqiturit av. _____ me adresë në Rr. _____ Hy _____, sipas nenit 16 të Rregullores për Procedurën Disiplinore të OAK-së të datës 07.03.2020, pas zhvillimit të seancës së shqyrtimit fillestar më datën 08.11.2022, merr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZHET** Propozimi i Prokurorit Disiplinor me nr.70-2/2021 të datës 29.09.2022 dhe Pushohet Procedura Disiplinore ndaj avokatit _____ nga _____
- II. Shpenzimet procedurale bien barrë e buxhetit të OAK-së.

A r s y e t i m

Kolegji Disiplinor i OAK-së, pas pranimit të Propozimit nga Prokurori Disiplinor i OAK-së, me nr.70-2/2021 të datës 29.09.2022, me datë 08.11.2022 ka caktuar dhe mbajtur shqyrtimin fillestar, në përbërje të plotë.

Në kuptim të nenit 35 paragrafi 3, Kolegji, ka bërë vlerësimin e gjitha provave veç e veç, ashtu që fillimisht shqyrtoi përmbajtjen e emailit të datës 26.09.2022, të dërguar nga prokurori disiplinor, për drejtorin e OAK -së, në të cilën ishin parashtruar dy pyetje, me përmbajtje citoj: "1. A ka pranuar Kryetari i OAK -së ndonjë pagë prej 1974 euro" "2. A ka kushtuar ndonjë lloptop i blerë nga ODA në vlerë prej 10000 euro", përfundon citimi.

Krahas kësaj, kolegji ka administruar edhe përmbajtja e emailit të datës 27.09.2022 të dërguar nga Drejtori Ekzekutiv i OAK, për Zyrtaren e Financave, ku është kërkuar përgjigje nga të dhënat financiare, lidhur me pyetjet e parashtruara si më larë.

Kolegji vlerësoi edhe përmbajtjen e emailit, nga zyrtarja e financave për drejtorin ekzekutiv, lidhur me pyetjet e parashtruara. Me përmbajtje, citoj *“1. JO, Kryetari i OAK-se, asnjehere nuk ka pranuar pagese ne vleren prej 1974 euro nga OAK” “2. JO, Asnjrhere, asnje lloptop nuk ka kushtuar ne vlere prej 10000 euro”* përfundon citimi.

Kolegji edhe në përfundim se ky lloj komunikimi, pavarësisht se ishte bashkëngjitur si provë në procedurë, të njëjtat nuk kanë cilësinë e tillë, pasi që nuk provojnë ndonjë element apo rrethanë, e cila do të përbënte shkelje disiplinore.

Kolegji me kujdes vlerësoi përmbajtjen e artikullit të publikuar nga portali “Betimi për Drejtësi” dhe shpërndarjes së këtij artikulli në profilin e tij në rrjetin social “Facebook” nga ana e të paraqiturit.

Shpërndarja nga ana e të paraqiturit, ishte bërë me mbishkrimin citim *“Kuvendi i rregullt i OAK - së!”* dhe është bashkëngjitur përmbajta e plotë e portalit “Betimi për Drejtësi.” Sipas kësaj rezulton se, nuk ishte bërë ndonjë deklarami shtesë përveç përmbajtjes së artikullit nga ana e portalit. Andaj këtë veprim nga ana e të paraqiturit, kolegji e vlerësoi se nuk përbën shkelje disiplinore të pretenduar si në propozim.

Në anën tjetër kolegji vlerësoj përmbajtjen e lajmit të bashkëngjitur në tërësinë e tij dhe posaçërisht pjesën e deklarameve nga ana e të paraqiturit.

Në lajmin e portalit, ishin përmbledhur punimet e Kuvendit të Rregullt të OAK-së, ku ishin parafrazuar edhe fjalimet e delegatëve, të cilët kishin marr fjalën dhe ishin paraqitur në foltoren e kuvendit, duke kërkuar llogari dhe përgjigje për çështjet e ndryshme brenda OAK -së.

I paraqituri në fjalën e tij, në cilësinë e delegatit ndër tjera kishte deklaruar, citim *“... Ka marr pagë në kohë pandemie në vlerën prej 1974 euro, afër 500 euro më shumë se sa i lejon Rregullorja... Pagesat nuk ishin të ligjshme për pagesat e lloptopëve. Ky këshill mbikëqyrës nuk na tha asgjë.”*

Lidhur me përmbajtjen e deklarameve të të paraqiturit, Kolegji Disiplinor, erdhi në përfundim se deklarimi i të paraqiturit në cilësinë e delegatit ishte bërë gjatë Kuvendit të Rregullt të OAK-së. Ky deklarim në tersin e tij kishte të bënte me punën e organeve të odës dhe kërkesës për llogaridhënie në çështjet e ngritura për diskutim, të cilat nuk janë në kuadrin e shkeljeve disiplinore.

Me rastin e shpërndarjes së artikullit i paraqituri nuk kishte deklaruar / shkruar, më shumë se ajo që ishte përmbledhur nga portali. I vetmi përshkrim ishte “Kuvendi i rregullt i OAK -së!”. Titulli nuk ishte ajo që avokati i paraqitur kishte deklaruar, titulli është autorësi e portalit dhe nuk ishte i njëjtte me deklarinimin e avokatit, gjatë punimeve të kuvendit.

Në këtë mënyrë kolegji pasi bëri vlerësimin e të gjitha provave veç e veç dhe të gjitha së bashku, erdhi në përfundimin se shpërndarja e artikullit të portalit “Betimi për Drejtësi” nuk përbëjnë përgjegjësi disiplinore në kuptim të nenit 119 të Statutit të OAK -së, lidhur me neni 8, 32 dhe 36 pika c të KEPA-së. Këto dispozita normative të OAK-së, i referohen sjelljeve të avokatit në jetën e tij private, komunikimin me shkrim të avokatit dhe obligimin e tij për të ruajt autoritetin dhe prestigjin e avokatisë, gjatë ushtrimit të profesionit, në raport me organet e odës dhe institucionet e tjera.

Nga ajo që u tha, Komisioni Disiplinor i OAK -së, në kuptim të nenit 19 paragrafi 1 pika 1.1 të Rregullores për Procedurën Disiplinore për Avokat dhe Praktikant, konstatohet se nga shkresat e lëndës nuk rezulton se kemi të bëjmë me shkelje disiplinore.

KËSHILL JURIDIKE

Kundër këtij vendimi, palët kanë të drejtë të paraqesin ankesë në afat prej 8 ditësh nga dita e pranimit të vendimit përmes këtij Komisioni për Komisionin e Ankesave të OAK- së.

Komisioni Disiplinor i Odës së Avokatëve të Kosovës
V.KD. Nr.23-1/2022 të dt:08.11.2022

Procesmbajtësja:
Ma.sc.Vjollca Ajeti



Kryetare e Kolegjit Disiplinor:
Av. Sarandë Beqiri

